

VENDIM
Nr.537, datë 20.11.2006

**MBI SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR RINOVIMIN E LICENCËS DHE
MIRATIMIT TË MASËS SË GJOBËS TË VENDOSUR NDAJ SUBJEKTIT “RADIO KOHA”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Ledi	Bianku	Kryetar
Mesi	Doda (Demi)	Zëvendëskryetare
Frano	Kulli	Anëtar
Detar	Hysi	Anëtar
Alban	Karapici	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence dhe anulimin e masës së gjobës, të paraqitur nga subjekti radiofonik privat vendor “Radio Koha”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 137/4 dhe neni 25 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr.479, datë 29.6.2006 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit vendor “Radio Koha”, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” të KKRT-së, si dhe ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VËREN SE:

Mbështetur në vendimin nr.479, datë 29.6.2006 të KKRT-së “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit vendor “Radio Koha””, subjekti radiofonik “Radio Koha” nuk u rilicencua, pasi mungonin:

- vendimi i gjykatës dhe depozitimet e bëra në regjistrin tregtar;
- të dhënat mbi kapitalin financiar, i vërtetuar me ekspert kontabël;
- planin ekonomik-financiar për periudhën e rinovimit të licencës;
- të dhënat mbi programet;
- deklaratat mbi vërtetësinë e të dhënave të paraqitura.

Bazuar në pikën 2 të vendimit, subjekti kishte të drejtë që brenda një afati 30-ditor të depozitonte plotësimet e nevojshme.

Në datën 8.8.2006, subjekti radiofonik vendor “Radio Koha” depozitoi plotësimet e kërkuara dhe nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të plotësuar për rinovim licence nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, u konstatua se subjekti “Radio Koha”:

- Nuk kishte respektuar nenin 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit: “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës... jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve”. Konkretisht, subjekti “Radio Koha” nuk kishte njoftuar KKRT-në për ndryshimet e kryera në shoqërinë “Juli&Visi” sh.a. me vendimin nr.28996/2, datë 15.5.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit është vendosur depozitimi i vendimit të aksionarëve për shitjen e aksioneve të aksionarëve Nikoll Lesi, Natalia Lesi, Bardhyl Ucaj tek aksionari i ri z.Arjan Prodani, i cili tani zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë. Selia e shoqërisë do të jetë në Rr. “Donika Kastrioti”, nr.9 Tiranë. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga Shkëlqim Prodani, Valbona Prodani, Ergys Likaj. Drejtor ekzekutiv i shoqërisë është z.Arjan Prodani”. Për këtë shkelje, subjekti u ndëshkua nga grupi i inspektimit me gjobën nr.153, datë 30.10.2006, në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

- Nuk kishte paraqitur projektin teknik të studios.

- Nuk kishte paraqitur listën e aparaturave dhe pajisjeve teknike që përdoren për prodhimin e programeve etj.

Për sa më sipër, subjekti “Radio Koha” u njoftua me shkresën nr.674/1 prot., datë 30.10.2006 të KKRT-së, duke i bërë të ditur se pas depozitimit të plotësimeve të kërkuara brenda datës 6.11.2006 (përfshirë dhe shlyerjen e gjobës), KKRT-ja do të marrë vendimin përfundimtar në rinovimin ose jo të licencës.

Me shkresën e datës 6.11.2006, subjekti “Radio Koha” ka depozituar plotësimin e

dokumentacionit sipas shkresës nr.674/1 prot., datë 30.10.2006 të KKRT-së, si dhe kërkesën për rinovimin e licencës dhe anulimin e gjobës nr.153, datë 30.10.2006, me pretendimin se:

“...Nga ana jonë, një njoftim i tillë është konsideruar i mjaftueshëm, në respektim të kërkesave tuaja. Dërgimin e vendimit përkatës të gjykatës, për ndryshim aksionarësh, e kemi konsideruar dhe vazhdojmë ta konsiderojmë të plotë dhe të mjaftueshëm...”.

KKRT-ja vëren se, edhe pas këtij pretendimi, subjekti “Radio Koha” nuk parashtron asnjë argument për të provuar të kundërtën e faktit, se ndryshimet e të dhënave që kanë ndodhur në kërkesën për marrjen e licencës, “Radio Koha” duhet të kishte njoftuar jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve, sipas nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, KKRT-ja e gjen sanksionin me gjobë të vendosur nga grupi i inspektimit ndaj subjektit “Radio Koha”, në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë, të drejtë dhe të mbështetur në ligj e në fakte.

Në këto kushte, KKRT-ja vëren se subjekti radiofonik vendor “Radio Koha”, gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, e konkretisht të nenit 30 të tij, sipas të cilit: “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës... jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve.”.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 3 të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, vendimit nr.479, datë 29.6.2006 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit vendor “Radio Koha”, si dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të miratojë masën e gjobës së vendosur nga grupi i inspektimit të KKRT-së ndaj subjektit “Radio Koha” në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Të mos rinovojë licencën e subjektit radiofonik privat vendor “Radio Koha”.
3. Licenca me nr.042/FML bëhet e pavlefshme.
4. Subjekti “Radio Koha” është i detyruar të ndërpresë menjëherë transmetimin.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku